

# Gjyqtari Gjin Gjoni dorëhiqet në prag të vetingut

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit në Tiranë, Gjin Gjoni i paraqiti Këshillit të Lartë Gjyqësor dorëheqjen, duke iu shmangur procesit të vetingut, ndërsa në një letër të rrjedhur në media ai akuzon procesin si joprofesional dhe politikisht të varur.

Autor: [Vladimir Karaj](#) | BIRN | Tiranë



Gjyqtari Gjin Gjoni | Foto : LSA

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit në Tiranë, Gjin Gjoni i ka paraqitur të hënën dorëheqjen e parevokueshme Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke shmangur përballjen me procesin e vetingut. Në një letër të të publikuar nga Lapsi.al, Gjoni pretendon se ishte sulmuar politikisht dhe lë të kuptohet se edhe në veting do i nënshtrohej një procesi politik.

Kërkesa e Gjoni për dorëheqje u konfirmua nga anëtari i Këshillit, Erjon Muharremaj.

Gjyqtari Gjoni është një figurë kontraverse e sistemit të drejtësisë. Në vitin 2014, ai u akuzua nga kryeministri Edi Rama si “fenomenal”, duke iu referuar problemeve të sistemit të drejtësisë. “Po e them copë, sepse jam ndier i tmerruar kur kam përballë zyrtarët më të lartë të vendeve të tjera që e përmendin si emër?”, tha Rama duke pretenduar se Gjoni i ishte përmendur në tavolinë nga disa kancelari të huaja.

Nga ana tjetër, ish-kryeministri Sali Berisha e ka mbrojtur haptazi Gjonin. Gjatë një seance parlamentare në replikë me ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri,

Berisha tha se ata që akuzonin Gjonin duhej të “lajnë gojën” përpara se të flasin, sepse ai ka pasur kurajën të përballet me drejtësinë.

Gjoni [është një nga gjyqtarët më të pasur](#) në vend sipas vetëdeklarimeve të dorëzuara në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave. Ai dhe bashkëshortja Elona Çausi u kallëzuan nga ILDKPKI në vitin 2014 për mosdeklarim pasurie dhe konflikt interesi, [por hetimet e prokurorisë së Elbasanit u pushuan pas një sërë vendimesh të gjykatave](#) në të tre shkallët që fillimisht ndaluan zgjatjen e afateve dhe më pas vendosën se “fakti nuk ekzistonte” dhe se Gjoni e bashkëshortja nuk kishin “pasuri të padeklaruara dhe të pajustificuara, apo burim të paligjshëm të financimit të tyre.”

Gjyqtari Gjoni u shortua për t’iu nënshtruar procesit të vetingut në vitin 2018, ndërkohë që në tetor të të njëjtit vit ai mori leje prindërore 2-vjeçare nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në letrën e tij të dorëheqjes, Gjoni pretendon se vetingun po e kalojnë vetëm “shërbëtorët e politikës” dhe ata që “firmosin dhe vulosin pa menduar”.



RRETH AUTORIT

### [Vladimir Karaj](#)

Vladimir Karaj është redaktor i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri, BIRN Albania.